

VENDIM
Nr.725, datë 1.9.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT, PËR DHËNIEN ME QIRA,
ME ÇMIMIN 1 (NJË) EURO, TË SIPËRFAQES PREJ 87 586.8 M² TË NDËRMARRJES
SË PRODHIMIT TË ÇELIQEVE, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, dhe të pikës 3, të kreut IV, të vendimit nr.1712, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien me qira, me çmimin 1 (një) euro/kontrata, të një sipërfaqeje prej 87 586.8 (tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë tetë) m², të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqueve, Elbasan, për zhvillimin e një veprimtarie prodhuese.

2. Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të këtij objekti do të jenë:

- a) Investimi 50 pikë;
- b) Punësimi 30 pikë;
- c) Koha e fillimit të punës 20 pikë.

3. Për dhënien me qira të zbatohen procedurat e përcaktuara në vendimin nr.1712, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”, të ndryshuar.


4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN VENDOSJA E OBJEKTIT "TRUALLI LIRE" PRANE
 PRODHIMIT ÇELIQEVE ELBASAN QE DOTE JEPET NE PE
 SIPERFAQJA TOTALE =87586.80

PLANIMETRIA OBJEKTIT "TRUALLI LIRE" SH. 1:2500



KUFIZIMET

NGA VERIU
 NGA JUGU
 NGA LINDJA
 NGA PERENDIMI

RRUGE + OBJEKTE
 RRUGE
 RRUGE + OBJEKTE
 TRUALLI TE LIRE

PUNOI

ING. Ferdinand SHUTERIGI LIÇ N:

TOP Astrit SHKALLA LIÇ N: T.Z. 4

ERMARRJES
 DORIM

PREFEKTI QARKUT ELBASAN

/ Shefqet DHALLISI /


SEKTORI I KOPETENCAVE VENDORE
 PER URBANISTIKEN

/ ING. MIMOZA SEJDINI /

DREJTORI N.P. ÇELIQEVE ELBASAN

/ Ilir ROPI /

VEND NDODHJA E OBJEKTIT



FRAGMENT I KOMBINATIT METALURGJIK ELBASAN
 SH.1: 7500

07/25/101.06/06/09

13 Dt. 31/10/08